Posta Shqiptare sh.a
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
(Të gjitha shumat janë paraqitur në Lek)
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
Me 31 Dhjetor 2014

	Shenime	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013 i Riparaqitur
AKTIVE			
Aktivet afatgjata			
Aktivet afatgjata materiale	4	2,416,716,864	2,546,931,567
Aktivet afatgjata jomateriale	5	40,730,628	36,900,517
Aktive afatgjata financiare	6	450,000,000	450,000,000
Pjesemarrje te tjera ne njesi te kontrolluara	7	1,000,000	1,000,000
Total Aktiveve Afatgjata		**2,908,447,492**	**3,034,832,084**
Aktivet afatshkurtra			
Inventarë	8	206,498,951	183,805,323
Llogari te arketueshme tregetare	9	567,812,015	543,280,368
Llogari te arketueshme te tjera	10	1,200,466,124	1,181,658,763
Mjetet monetare ne arke e ne banke	11	2,364,237,428	1,368,944,007
Total aktive afatshkurtra		**4,339,014,518**	**3,277,688,461**
Total Aktive		**7,247,462,010**	**6,312,520,545**
Kapitali aksionar			
Kapitali aksionar		1,642,447,000	1,642,447,000
Rezerva nga rivleresimi		1,380,951,364	1,448,592,294
Rezerva ligjore		103,250,221	103,250,221
Rezerva te tjera		1,044,369,902	1,044,369,902
Fitime te mbartura		12,068,326	61,249,922
Totali i te ardhurave gjitheperfshirese		229,699,353	(116,822,527)
Total kapitali aksionar	12	**4,412,786,166**	**4,183,086,812**
DETYRIMET			
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata		-	
Tatimi i shtyre mbi fitimin	13	194,319,765	145,882,590
Detyrime te tjera afatgjata	14	450,000,000	450,000,000
Total Detyrime afatgjata		**644,319,765**	**595,882,590**
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra		-	
Llogari te pagueshme tregetare	15	265,386,386	129,485,547
Detyrimet tatimore	16	36,823,680	41,848,068
Detyrime ndaj punonjesve	17	5,935,044	12,371,344
Provizione per rreziqe		-	-
Grante,te ardhura te shtyra e te tjera detyrime	18	10,894,081	8,278,745
Llogari te pagueshme te tjera	19	1,871,316,888	1,341,567,439
Total Detyrime afatshkurtra		**2,190,356,079**	**1,533,551,143**
Totali i detyrimeve		**2,834,675,844**	**2,129,433,733**
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		**7,247,462,010**	**6,312,520,545**

Shënimet shpjeguese janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

REPUBLIKA E SHQIPERISE POSTA SHQIPTARE SH.A TIRANE

PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

	Shenime	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013 i Riparaqitur
Te ardhura	20	2,025,510,628	1,785,061,876
Te ardhura te tjera jo operative	20	5,830,979	294,864
Materiale te para dhe te konsumueshme	21	(216,347,636)	(207,183,840)
Shpenzime personeli	22	(998,898,868)	(1,067,731,234)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	23	(169,869,371)	(183,289,076)
Shpenzime te tjera	24	(359,641,670)	(357,300,526)
Fitimi operativ		**286,584,062**	**(30,147,936)**
Te ardhurat/shpenzime financiare nga njesite e kontrolluara			
Te ardhura/(Shpenzime) financiare Neto	25	57,099,775	6,848,023
Total shpenzime financiare		**57,099,775**	**6,848,023**
Fitimi para tatimit		**343,683,837**	**(23,299,913)**
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	26	(65,547,309)	(1,192,206)
Fitimi i vitit		**278,136,528**	**(24,492,119)**
Shpenzime tatim fitimi i shtyre		(48,437,175)	(92,330,408)
Rezultati Neto i vitit		**229,699,353**	**(116,822,527)**
Te ardhura te tjera te pergjithshme		67,640,930	68,548,521

Shënimet shpjeguese janë pjesë integrale e ketyre pasqyrave financiare.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË POSTA SHQIPTARE SH.A TIRANË

PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

	Shenime	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013 i Riparaqitur
Flukset e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi para tatimit		343,683,837	(24,492,119)
Axhustime për zërat jo-monetare:			
Zhvlerësimi dhe amortizimi		169,869,371	183,289,076
Nxjerrja jashtë përdorimit e Mjeteve fikseve, neto nga fitimi kapital		565,842	1,044,958
Tatim fitimi			
Fitimi operativ përpara ndryshimeve ne kapitalin qarkullues		**514,119,050**	**159,841,915**
Ndryshimi ne kapitalin qarkullues			
Ndryshimi ne inventar		(22,693,628)	(31,649,042)
Ndryshimi ne llogari te arketueshme dhe te tjera		(93,489,131)	(229,436,888)
Ndryshimi ne llogari te pagueshme dhe te tjera		654,189,601	(14,356,757)
Ndryshimi ne grante dhe te ardhura te shtyra		2,615,336	(483,210)
Mjetet monetare te gjeneruara nga aktivitetet operative		**1,054,741,228**	**(116,083,982)**
			-
Tatimi mbi fitimin i paguar gjate vitit		(15,397,184)	(1,192,206)
Mjetet monetare Neto te gjeneruara nga aktivitetet operative		**(15,397,184)**	**(1,192,206)**
Aktivitetet investuese			
Blerje te aktiveve afatgjata material		(44,050,623)	(50,331,985)
Rivleresim aktive afatgjata materiale			(963,861,287)
Shitja e aktiveve afatgjata materiale			(45,571)
Mjete monetare te gjeneruara nga aktiviteti investues		**(44,050,623)**	**(1,014,238,843)**
Aktivitetet financuese			
(Ripagim)/ te hyrat neto nga huate agjatgjata			
(Ripagim)/ te hyra nga hua afatshkrter			
Rritje rezerve rivleresimi			953,511,124
Transferim I plusvleres ne fitim/humbje te akumuluar			26,751,194
Dividendë paguar			(18,361,801)
Mjete monetare te gjeneruara nga aktiviteti financues		-	**961,900,517**
Ndryshimi neto i mjeteve monetare		**995,293,421**	**(169,614,514)**
Mjetet monetare ne fillim te periudhës		1,368,944,007	1,538,558,521
Mjetet monetare ne fund te periudhës		**2,364,237,428**	**1,368,944,007**

Shënimet shpjeguese janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË POSTA SHQIPTARE TIRANË

PASQYRA E LEVIZJES SË KAPITALEVE TË VETA
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

	Kapitali aksionar	Rezerva te tjera	Rezerva ligjore	Rezerva nga rivleresimi	Fitime te mbartura/humbje te akumuluara	Totali
31 Dhjetor 2012	**1,642,447,000**	**888,294,591**	**94,069,321**	**536,878,497**	**176,319,413**	**3,338,008,822**
Dividendë te paguar					(18,361,801)	(18,361,801)
Fitimi i vitit					(116,822,527)	(116,822,527)
Te ardhura te tjera te pergjitheshme				(68,548,521)	68,548,521	-
Rivleresim i aseteve 31 Dhjetor 2012				980,262,318		980,262,318
Transferim i rezultat te vitit paraardhes		156,075,311	9,180,900		(165,256,211)	-
31 Dhjetor 2013	**1,642,447,000**	**1,044,369,902**	**103,250,221**	**1,448,592,294**	**(55,572,605)**	**4,183,086,812**
						-
Dividendë te paguar						-
Fitimi i vitit					229,699,353	229,699,353
Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse:				(67,640,930)	67,640,930	-
31 Dhjetor 2014	**1,642,447,000**	**1,044,369,902**	**103,250,221**	**1,380,951,364**	**241,767,678**	**4,412,786,166**

Shënimet shpjeguese janë pjesë integrale e ketyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat Financiare të vitit 2014, së bashku me shënimet u aprovuan nga manaxhimi në datë ___/____ 2015 dhe u firmosën në emër të tij nga:

Drejtor i Përgjithshem

Dr/ Drejtorisë Ekonomike dhe të Financës

SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

1. INFORMACION I PËRGJITHSHEM

Shoqeria Posta Shqiptare sha eshte krijuar si shoqeri anonime me Vendim te Gykates se Rrethit Tirane Nr. 20718 date 03/02/1992. Aksioner i shoqerise eshte Ministria e Zhvillimit Tregtise dhe Sipermarrjes. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatese te Ligjit 7638 date 19.11.1992, Per shoqerite Tregtare" dhe ne vijim nga ligji Nr.9901 dt 14.04.2008, si dhe nga statuti i saj dhe legjislacioni shqiptar ne fuqi. Shoqeria eshte gjithashtu institucion financiar jobankar i licensuar si e tille nga Banka Qendrore dhe raporton ne menyre specifike per kete qellim.
Shoqeria kryen aktivitetin e saj ne ambjente qe jane ne pronesi te saj. Aktivet e qendrueshme prone e saj perbehen nga toka, ndertesa, paisje informatike, mjete transporti etj. Kapitali i shoqerise sipas vendimit te Gjykates se Rrethit Tirane perbehet nga kontributet e aksionerit te vetem, Ministria e Zhvillimit Tregtise dhe Sipermarrjes ne Shumen 1.642.447.000 leke, i ndare ne 1.642.447 aksione me vlere nominale 1000 leke secili, te cilat zoterohen 100% nga Ministria e Zhvillimit Tregtise dhe Sipermarrjes.
Shoqeria Posta Shqiptare sha drejtohet nga Keshilli Mbikqyres, i cili ka emeruar si Administrator te pergjithshem Z. Majlind Lazimi. Drejtoria ka autorizuar publikimin e pasqyrave financiare te konsoliduara ne daten __/__/2014.

Këshilli Mbikqyrës:

Emri	Funksioni
Sokol Dervishaj	Kryetar
Hasan Hoxha	Anëtar
Arbër Lleshi	Anëtar
Zamir Moçka (Stefani)	Anëtar
Matilda Shehu	Anëtar
Lorin Ymeri	Anëtar

Selia e shoqerisë është Rruga Rreshit Collaku Tiranë. Shoqëria është e regjistruar si person juridik ne Degën e Tatimpaguesve të Mëdhenj me NIPT J61924007N.

REPUBLIKA E SHQIPERISE POSTA SHQIPTARE SHA TIRANE

2. BAZA E PERGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në perputhje me rregullat dhe interpretimet e përcaktuara në ligjin Nr. 9228 datë 29 Prill 2004 "Mbi Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe me Standardet Ndërkombetare të Raportimit Financiar (SNRF) të aprovuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit. Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, me përjashtim te Aktiveve Afatgjata Materiale dhe Jomateriale të cilat paraqiten me vlerën e drejtë minus amortizimin e akumuluar.

2.2. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.3. Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Standardet e reja dhe interpretimet e mëposhtme u bënë efektive për Shoqërinë që prej 1 Janar 2014:

Amendimi në SNK 32, "Kompensimi i Aktiveve Financiare dhe Detyrimeve Financiare" ***(publikuar në Dhjetor 2011 dhe efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janar 2014).*** Amendimi shtoi udhëzime për aplikimin e SNK 32 i cili trajtonte mungesën e qëndrueshmërisë së identifikuar, gjatë aplikimit të kritereve te kompensimit. Ky udhëzim përfshin qartësimin e paragrafit " momentalisht ka një të drejtë të detyruar me ligj për kompensim" dhe që disa sisteme të shlyerjes bruto mund të konsiderohen si te njëvlefshme me ato të shlyerjeve neto. Standardi përcakton se një e drejtë për komensim (a) nuk duhet të kushtëzohet nga ngjarje në të ardhmen dhe (b) duhet të jetë i detyrueshëm me ligj në të gjitha rrethanat në vijim: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast likuidimi dhe falimentimi. Standardi i amenduar nuk ka një impakt material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Amendimi në SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 27 – Njësitë investuese" ***(publikuar në 31 Tetor 2012 dhe të bëra efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janar 2014).*** Ndryshimet prezantuan përkufizimin e një njësie investuese si një njësi që (i) siguron fonde nga investitorë me qëllim shpërblimin e tyre me shërbime të menaxhimit të investimeve, (ii) angazhohet tek investitorët që qëllimi i biznesit është investimi i fondeve vetëm për rritjen e vlerës së kapitalit ose të ardhurat nga investimi dhe (iii) mat dhe vlerëson investimet e saj në bazë të vlerës së drejtë. Një njësie investuese i kërkohet të përllogarisë për filialet vlerën e drejtë me fitim apo humbje dhe të konsolidojë vetëm ato filiale që ofrojnë shërbime të lidhura me aktivitetet investuese të njësisë. SNRF 12 u ndryshua për të futur mënyra të reja paraqitjeje, duke përfshirë gjykime të rëndësishme në përcaktimin nëse një njësi investuese dhe nëse informacioni financiar ose jo për një filial të pa konsoliduar është një synim apo i është ofruar filialit. Shoqëria nuk pret që ndryshimi të ketë ndonjë ndikim në pasqyrat e saj financiare.

Amendimi në KIRFN 21 – "Taksat" ***(publikuar në 20 Maj 2013 dhe të bëra efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janar 2014).*** Interpretimi qartëson kontabilizimin e një detyrimi tatimor që nuk është tatim fitim. Ngjarja që shkakton një detyrim është ajo ngjarje e identifikuar nga legjislacioni që shoqëron detyrimin me një pagesë takse. Fakti që njësia është ekonomikisht e detyruar të vazhdojë të operojë në një periudhë të ardhshme, ose përgatit pasqyrat financiare me supozimin e vazhdimësisë, nuk krijon një detyrim. Të njëjtat parime njohjeje aplikohen në pasqyrat financiare të ndërmjetme dhe vjetore. Zbatimi i interpretimit të detyrimeve që rrjedhin nga skemat e tregtimit të emetimeve është fakultativ. Shoqëria po vlerëson aktualisht ndikimin e ndryshimeve në pasqyrat financiare.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË POSTA SHQIPTARE SH.A TIRANË

2. BAZA E PERGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

2.3. Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale (vazhdim)

Amendimi në SNK 36 - "Dhënia e informacioneve shpjeguese për shumën e rikuperueshme të aktiveve jo-financiare" (të publikuara në Maj 2013 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janar 2014; aplikimi më herët është i lejuar nëse SNRF 13 zbatohet për të njëjtën kontabilitetit dhe të periudhës krahasuese). Amendimi heq kërkesën për të paraqitur informacion mbi shumën e rikuperueshme kur një njësi gjeneruese e mjeteve monetare ka emër të mirë ose asete jo-materiale me jetë të papërcaktuar, por nuk kapatur zhvlerësime. Standardi i ndryshuar nuk kishte një ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Amendimi në SNK 39 - "Rinovimi i Derivativëve dhe Vazhdimi i Kontabilitetit Mbrojtës" (publikuar në Qershor 2013 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë pas 1 Janar 2014). Ky ndryshim lejon "kontabilitetin mbrojtës" të vazhdojë në një situatën ku një derivativ, që është cilësuar si një instrument mbrojtjeje, zëvendësohet (pra, palët kanë rënë dakord për të zëvendësuar kundërpartinë origjinale me një të re) për të kryer anullimin me një kundërparti kryesore si rezultat i ligjeve apo rregullimeve, nëse janë plotësuar disa kushte specifike.

2.4. Standardet dhe interpretimet e publikuara por ende të pa përvetësuara

Ne datën e aprovimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e mëposhtme, interpretimet dhe rishikimet janë publikuar por nuk janë ende efektive:

- SNRF 9 "Instrumentat financiarë: klasifikimi dhe matja" (amenduar në Korrik 2014 dhe efektiv për periudhat më ose pas 1 Janar 2018).
- Amendime ne SNK 19 – "Skemat e përfitimeve të përcaktuara: Kontributet e punonjësve" (publikuar në Nëntor 2013 dhe efektiv për periudhat që fillojnë më 1 Korrik 2014).
- Përmirësimet vjetore për SNRF-të 2012 (publikuar në Dhjetor 2013 dhe efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 Korrik 2014, përvec kur shprehet ndryshe më poshtë).
- Përmirësimet vjetore për SNRF-të 2013 (publikuar në Dhjetor 2013 dhe efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 Korrik 2014).
- SNRF 14, Llogaritë e shtyra rregulatore (publikuar në Janar 2014 dhe efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 Janar 2016).
- Kontabilizimi për blerjet e interesave në Operacionet e Përbashkëta – Amendime në SNRF 11 (publikuar më 6 Maj 2014 dhe efektiv për periudhat që fillojnë më ose pas 1 Janar 2016).
- Qartësimi i metodave të pranueshme për Amortizimin dhe Zhvlerësimin – Amendime në SNK 16 dhe SNK 38 (publikuar më 12 Maj 2014 dhe efektiv për periudhat më ose pas 1 Janar 2016).
- SNRF 15, "Të ardhurat nga Kontratat me Klientët" (publikuar më 28 Maj 2014 dhe efektiv për periudhat qe fillojnë më ose pas 1 janar 2017).
- Bujqësi: Bimët Prodhuese – Amendime në SNK 16 dhe SNK 41 (publikuar më 30 Qershor 2014 dhe efektiv për periudhat që fillojnë më 1 Janar 2016).
- Metoda e kapitalit në pasqyrat financiare individuale – Amendimet në SNK 27 (publikuar më 12 Gusht 2014 dhe efektiv për periudhat që fillojnë më 1 Janar 2016).
- Shitje ose Kontribut në asete midis një Investitori dhe bashkëpunëtorit te tij ose sipërmarrjes së përbashkët – Amedime në SNRF 10 dhe SNK 28 (publikuar më 11 Shtator 2014 dhe efektiv për periudhat qe fillojnë më ose pas 1 Janar 2016).
- Përmirësimet vjetore për SNRF-të 2014 (publikuar në 25 Shtator 2014 dhe efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 Janar 2016).
- Dhënia e informacioneve shpjeguese sipas Amendimeve të SNK 1 (publikuar në Dhjetor 2014 dhe efektiv për periudhat më ose pas 1 Janar 2016).
- Njësite ekonomike investuese: Aplikimi i Përjashtimit të Konsolidimit amendim në SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 28 (publikuar në Dhjetor 2014 dhe efektiv për periudhat me ose pas 1 Janar 2016).

REPUBLIKA E SHQIPËRISË POSTA SHQIPTARE SH.A TIRANË

2. BAZA E PERGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

Kompania ka zgjedhur të mos i përvetesojë këto standarde, rishikime dhe interpretime para datës që ato do të behën efektive. Kompania parashikon se përvetesimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do te ketë ndikim material në pasqyrat financiare të kompanisë në periudhën e aplikimit fillestar të tyre.

2.5. Monedha raportuese

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë. Të gjitha informacionet financiare janë rrumbullakosur në mijëshen më te afërt, përveçse kur deklarohet ndryshe.

2.6. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke perfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e eksperteve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet qe kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.6.1. Zhvlerësimi i inventarëve

Shoqëria vlerëson gjëndjen e inventarit me qarkullim të ulët dhe inventarin i cili ka humbur vlerën e përdorimit për shkak të zhvillimeve teknologjike apo arsyeve të tjera, me synim për të përcaktuar masën e zhvlerësimit të inventarit, bazuar në përdorimin e ardhshëm të tij dhe në llogaritjen e vlerës neto të realizueshme. Në rast se vlera neto e realizueshme e inventarit është më e ulet se vlera kontabël neto, ekziston një tregues që inventari është i zhvlerësuar. Shoqëria përdor gjykimin e saj për të përcaktuar masën e zhvlerësimit.

2.6.2. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arketueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga paaftesia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Keto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çrregjistrimin, vlerësimin e aftesisë paguese të konsumatoreve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve.
Shoqeria nuk ka ndonje politike te miratuar per krijimin e zhvleresimit te llogarive te arketueshme.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË POSTA SHQIPTARE SH.A TIRANË

2. BAZA E PERGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

2.6. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)

2.6.3. Provizionet

Provizionet në pergjithesi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqesore. Shoqëria vlerëson mundesinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhoje e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria duhet te provizionoj vlerën e detyrimit që mund të mase me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund te mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Shoqeria nuk ka ndonje politike te miratuar per krijimin e provizioneve.

2.7 Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Shifrat krahasuese janë riklasifikuar konform ndryshimeve në paraqitje në periudhën aktuale raportuese. Ndryshimet përfshijne riklasifikime brenda zërave të seksionit të aktiveve dhe pasiveve në pasqyrën e pozicionit financiar si edhe në pasqyrën e fitim humbjes.

AKTIVE	31.12.2013	Riparaqitje per efekt krahasueshmerie	31.12.2013
Aktivet afatgjata materiale	2,546,931,567	-	2,546,931,567
Aktivet afatgjata jomateriale	36,900,517	-	36,900,517
Aktive afatgjata financiare	450,000,000	-	450,000,000
Pjesemarrje te tjera ne njesi te kontrolluara	497,357,589	(496,357,589)	1,000,000
Total Aktiveve Afatgjata	**3,531,189,673**	**(496,357,589)**	**3,034,832,084**
Aktivet afatshkurtra			
Inventarë	183,805,323	-	183,805,323
Llogari te arketueshme tregetare	969,500,368	(426,220,000)	543,280,368
Llogari te arketueshme te tjera	259,081,174	922,577,589	1,181,658,763
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	-	-	-
Mjetet monetare ne arke e ne banke	1,368,944,007	-	1,368,944,007
Total aktive afatshkurtra	**2,781,330,872**	**496,357,589**	**3,277,688,461**
Total aktive	**6,312,520,545**	**-**	**6,312,520,545**
Kapitali aksionar			
Kapitali aksionar	1,642,447,000	-	1,642,447,000
Rezerva nga rivleresimi	1,490,389,621	(41,797,327)	1,448,592,294
Rezerva ligjore	103,250,221	-	103,250,221
Rezerva te tjera	1,044,369,902	-	1,044,369,902
Fitime te mbartura	73,004,768	(11,754,846)	61,249,922
Totali i te ardhurave gjithperfshirese	(24,492,118)	(92,330,409)	(116,822,527)
Total kapitali aksionar	**4,328,969,394**	**(145,882,582)**	**4,183,086,812**

REPUBLIKA E SHQIPERISE POSTA SHQIPTARE SH.A TIRANE

(Të gjitha shumat janë paraqitur në Lek)

DETYRIMET			
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata		-	
Tatimi i shtyre mbi fitimin		145,882,590	145,882,590
Detyrime te tjera afatgjata	450,000,000	-	450,000,000
Total Detyrime afatgjata	**450,000,000**	**145,882,590**	**595,882,590**
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra		-	
Llogari te pagueshme tregetare	31,563,598	97,921,949	129,485,547
Detyrimet tatimore	41,848,068	-	41,848,068
Detyrime ndaj punonjesve	12,371,344	-	12,371,344
Provizione per rreziqe	-	-	-
Grante,te ardhura te shtyra e te tjera detyrime	8,278,745	-	8,278,745
Llogari te pagueshme te tjera	1,439,489,396	(97,921,957)	1,341,567,439
Total Detyrime afatshkurtra	**1,533,551,151**	**(8)**	**1,533,551,143**
Totali i detyrimeve	**1,983,551,151**	**145,882,582**	**2,129,433,733**
Totali i kapitalit dhe detyrimeve	**6,312,520,545**	**-**	**6,312,520,545**

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TE RENDESISHME KONTABEL

Shoqëria ka përdorur në mënyrë të vazhdueshme politikat kontabël të paraqitura në vijim:

3.1. Instrumentat Financiarë

Shoqëria ka vetëm instrumenta financiarë jo-derivativë, të përbërë nga llogari të arkëtueshme, likuiditete dhe vlera arke të tjera, hua të marra dhe të dhëna, dhe llogari të pagueshme. Shoqëria nuk ka instrumenta financiarë të mbajtura me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes apo të disponueshme për shitje ne datën e raportimit.

3.1.1.Njohja fillestare dhe çregjistrimi

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç rasteve siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në shpenzime dhe të ardhura.

Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërise perfundojne, skadojnë, shfuqizohen ose anullohen.
Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

3.1.2.Njohja e mëtejshme

Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuvalentët e parasë (mjetet monetare) përfshijnë tepricat e arkës, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllime të pasqyrës së fluksit të parasë, paraja dhe ekuivalentët të saj përfshijnë depozita pa afat dhe ato me një maturimi prej tre muajsh ose më pak që nga data fillestare. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre maten më tej me koston e amortizuar pakësuar me humbjet nga zhvlerësimet.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË POSTA SHQIPTARE SH.A TIRANË

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TE RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.1. Instrumentat Financiare (vazhdim)

3.1.2 Njohja e mëtejshme

Huatë dhe Llogari të arkëtueshme

Huatë e dhëna dhe Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Llogaritë e arkëtueshme afatshkurtra nuk skontohen.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv nëse është materiale.

Zhvlerësime të aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet si i zhvlerësuar në ato raste kur ekzistojnë kushte objektive që tregojnë se një apo më shumë ngjarje (pas njohjes së tij fillestare) kanë efekte negative në flukset e ardhshme të parasë që parashikohet të burojnë prej atij aktivi. Veshtiresitë e konsiderueshme financiare të debitorit, propabiliteti që debitori do të falimentojë apo një riorganizim financiar, dhe pamundesia apo shkeljet në pagesa janë disa shembuj treguesish për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme. Aktivet e rëndësishme financiare testohen në mënyrë individuale për zhvleresim. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, mbi baze grupesh që kanë karakteristika të ngjashme të riskut financiar.

Humbja nga zhvlerësimi lidhur me një aktiv financiar të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferenca midis vlerës kontabël të aktivit dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parasë, të skontuara me normën efektive të interesit të aktivit.

Vlera kontabël neto e një aktivi zvogelohet nëpërmjet llogarisë për zhvleresime dhe vlera e humbjes nga zhvleresimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi vazhdojnë të rriten mbi vlerën kontabël të aktualizuar, bazuar në normën fillestare të interesit efektiv. Llogaritë e arkëtueshme së bashku me fondin rezervë të zhvleresimit që i shoqëron, çregjistrohen atëhere kur nuk ka shpresa për rikuperim real në të ardhmen.

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit. Nëse në nje vit pasues, shuma e humbjeve të vlerësuara nga zhvlerësimi rritet apo ulet për shkak të një ngjarje pas njohjes fillestare të aktivit, humbja nga zhvlerësimi i njohur më parë rritet apo reduktohet duke rregulluar llogarinë e fondit rezervë të zhvlerësimeve. Nëse një aktiv i çregjistruar më parë, rikuperohet, ky rikuperim njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirese.

3.1.3 Kompensimi i instrumentave financiare

Aktivet dhe pasivet financiare kompensohen dhe paraqiten neto në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm nëse ekziston një e drejtë ligjore për të kompensuar shumat e njohura dhe qëllimi që shlyerja të realizohet mbi baza neto, apo të realizohet aktivi dhe te shlyhet detyrimi njëkohësisht. Kjo vlen kryesisht për balancat ndaj/dhe nga operatorët e tjerë të telekomunikacioneve kombëtare dhe nderkombëtare, të cilat shlyhen në shumën neto, në përputhje me kontratat ekzistuese.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË POSTA SHQIPTARE SH.A TIRANË

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TE RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.1. Instrumentat Financiare (vazhdim)

3.1.4 Përcaktimi i Vlerës së Drejtë

Vlera e drejtë e parasë dhe e likuiditeteve, llogarive të arkëtueshme dhe llogarive të pagueshme janë afërsisht të barabarta me vlerën kontabël të dhënë, për shkak te maturimit të tyre afatshkurtër.

3.2 Inventari

Inventare njihen me vleren me te voglen mes kostos dhe vleres neto te realizueshme.
Vlera e realizueshme neto është çmimi i shitjes i përllogaritur gjatë rrjedhës normale të biznesit minus kostot e përllogaritura për përfundimin dhe realizimin e shitjes. Kostot e inventarit janë përllogaritur duke u bazuar në metodën e mesatares së ponderuar dhe perfshin shpenzimet e kryera gjatë blerjes së inventarit dhe e dërgimit te tyre në kushtet dhe vendodhjen ekzistuese.

3.3 Aktivet Afatgjata Materiale

Aktivet Afatgjata Materiale janë të paraqitura me vlerën e drejtë duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kosto historike përfshin çmimin e blerjes, përfshirë detyrimet e importit, dhe taksa te pakthyeshme në blerje, pasi pakësohet nga zbritjet tregëtare, çdo kosto tjetër për të sjellë aktivin në vendndodhjen dhe kushtet e nevojshme në mënyrë që të jetë i gatshëm për përdorim në mënyrën e parashikuar nga manaxhimi i shoqërisë, si dhe kostot per çmontimin e asetit në rast se është e nevojshme.

Kostot e mëpasshme janë përfshirë në vlerën e mbartur të asetit, ose njihen si aset më vete, sipas rastit, vetem nëse është e mundur që përfitime ekonomike të ardhshme të lidhura me zërin ne fjalë, do të rrjedhin në shoqëri dhe kosto e tyre mund të matet në mënyrë të besueshme. Vlera e mbartur e një pjese që zëvendësohet çrregjistrohet. Të gjitha kostot e mirëmbajteve dhe riparimeve i ngarkohen periudhës financiare në të cilën kane ndodhur.

Ndërtimi në proçes përfshin punën e kontraktuar nga palët e treta ose punën e gjeneruar për qëllime të brendshme për aktivet afatgjata materiale ende te papërfunduara. Ky zë paraqet investimet e kryera (por ende te papërfunduara) në periudhën aktuale dhe/ ose paraardhesë financiare. Pas përfundimit, keto aktive dhe shumat e lidhura me to të mbartura nën zërat e parapagimeve në avancë, ose ndërtimeve në proçes, kapitalizohen si zëra të aktiveve afatgjata materiale.

Për të përcaktur nëse një aktiv qe ka në përbërjen e tij si elemente materialë ashtu dhe jomaterialë, duhet të trajtohet sipas SNK 16 - Aktivet Afatgjata Materiale apo sipas SNK 38 - Aktive afatgjata jomateriale, manaxhimi përdor gjykimin për të përcaktuar se cili element është më i rëndësishëm, në mënyrë që të rregjistrojë aktivin siç duhet.

Normat vjetore të amortizimit aplikohen mbi vlerën e mbetur të aktiveve dhe janë si vijon:

Aktivet afatgjata materiale	Norma e amortizimit %	
	2014	2013
Ndërtesa	5	5
Makineri e pajisje	20	20
Mjete transporti	20	20
Mobilje orendi	20	20
Pajisje elektronike	25	25

REPUBLIKA E SHQIPERISE POSTA SHQIPTARE SH.A TIRANE

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TE RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.3 Aktivet Afatgjata Materiale (vazhdim)

Amortizimi nuk aplikohet për tokën dhe punimet në proçes.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi dhe ndryshohen në rast se efektet janë materiale.

Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, percaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.4 Aktivet afatgjata Jomateriale

Aktivet afatgjata jomateriale përfshijnë liçensat dhe te drejtat për përdorim.

Njohja dhe Matja

Liçencat, të drejtat e përdorimit të cilat përftohen nga shoqëria paraqiten me vleren e drejte minus amotizimin e akumuluar (shihni më poshtë) dhe humbjet e akumuluara nga zhvlerësimi, nëse ka.

Shpenzimet e mëpasshme

Shpenzimet e mëpasshme kapitalizohen vetëm në rastin kur shtojnë përfitimet e ardhshme ekonomike për aktivin specifik me të cilat ato lidhen. Te gjitha shpenzimet njihen si fitim/humbje kur ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirese duke përdorur metoden lineare mbi jetëgjatesinë e parashikuar të aktiveve jomateriale që nga data që janë të disponueshme për përdorim.

Aktivet jo-materiale amortizohen me normen 15% mbi vleren e drejte.

3.5 Zhvlerësimi (Rënia në vlerë)

Shoqëria vlerëson në çdo datë raportimi nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësimin e aktiveve. Në rast se evidentohen tregues të tillë, atëhere vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit. Për aktivet jomateriale që nuk janë të gatshme për përdorim, vlera e rikuperueshme përllogaritet në çdo datë të bilancit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet atëhere kur vlera e mbartur e aktivit apo njësisë gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e parasë është njësia më e vogel e identifikueshme e grupit të aktiveve e cila gjeneron flukse monetare në mënyre të pavarur nga aktivet e tjera. Humbjet nga zhvlerësimet njihen në fitim/humbje. Vlera e rikuperueshme e një aktivi apo një njësie që gjeneron flukse paraje është më e madhja midis vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Për të vlerësuar vlerën në përdorim, flukset e ardhshme monetare të çmuara aktualizohen duke përdorur normën para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rrezikun specifik të aktivit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - POSTA SHQIPTARE SH.A - TIRANË

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.6 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.7 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar (nësë është materiale) flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3.8 Konvertimi i monedhave te huaja

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës në të cilin është kryer transaksioni. Aktivet dhe pasivet monetare në monedhë të huaj në datën e mbylljes së bilancit janë rivlerësuar në monedhën funksionale sipas kursit të shpallur nga Banka e Shqiperisë në datën e mbylljes së periudhës ushtrimore. Diferencat që rrjedhin si rezultat i rikonvertimit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.
Kurset zyrtare të këmbimit për monedhat kryesore të përdorura në konvertimin e gjëndjeve të bilancit emërtuara në monedhë të huaj në datën e hartimit të bilancit janë si më poshtë (ne LEK):

Monedha	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
1 EUR	140.14	140.20
1 USD	115.23	101.86
1 SDR	166.90	156.86

3.9 Njohja e të ardhurave

Te ardhurat njihen ne masen qe eshte e mundur qe perfitime ekonomike do te hyjne ne Shoqeri dhe qe te ardhurat mund te maten ne menyre te besueshme, pavaresisht se kur behet pagesa. E ardhura matet me vlere te drejte te shperblimit te mare per sherbimin e kryer dhe mallrat e shitura, neto nga tatimi mbi vleren e shtuar dhe zbritje te mundshme te shitjeve.

3.10 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat për fondet e depozituara në bankë dhe fitimet nga kurset e këmbimit. Të ardhurat nga interesat njihen kur realizohen duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit, humbjet nga kurset e këmbimit dhe humbjet nga zhvlerësimi të njohura në aktivet financiare.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË POSTA SHQIPTARE SH.A TIRANË

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.11 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbehet nga tatimi aktual adhe tatim fitimi i shtyre. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2014 eshte 15% (2013: 10%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili perllogaritet per te evidentuar diferencat e perkohshme që krijohen per shkak të aplikimit te parimeve kontabel te ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normen tatimore ne fuqi mbi diferencen ndermjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të ketyre aktive dhe detyrime për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.
Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.12 Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shendetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

3.13 Aktivet dhe Detyrimet e Kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që perfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtezuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

3.14 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishem në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërise dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË POSTA SHQIPTARE SH.A TIRANË

(Të gjitha shumat janë paraqitur në Lek)

4. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

	Toka	Ndertesa	Makineri & Pajisje	Mjete transporti	Mobilje e Orendi	Pajisje informatike	AQT ne Proces	Totali
Kosto								
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	304,303,068	1,269,405,152	101,707,725	138,626,505	243,224,859	191,296,536	1,614,000	2,250,177,845
Rivleresimi	77,658,601	901,693,970	(1,211,560)	(3,672,895)	(6,047,312)	(2,597,769)		965,823,035
Shtesa	-	-	79,418,230	767,694	21,696,051	63,533,897	1,076,000	166,491,872
Pakesime			(72,777,982)	(694,495)	(4,144,940)	(40,379,366)		(117,996,783)
sistemime	(1,961,750)	(268,532,630)	(19,908,211)	(81,325,114)	(100,213,761)	(69,745,572)		(541,687,038)
Riklasifikime		(7,093,038)	6,614,261	(136,431)	681,237	(66,029)		-
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	**379,999,919**	**1,895,473,454**	**93,842,463**	**53,565,264**	**155,196,134**	**142,041,697**	**2,690,000**	**2,722,808,931**
Shtesa			1,580,321	7,450,000	19,029,292	5,120,810		33,180,423
Pakesime				(674,182)				(674,182)
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	**379,999,919**	**1,895,473,454**	**95,422,784**	**60,341,082**	**174,225,426**	**147,162,507**	**2,690,000**	**2,755,315,172**
Amortizimi i akumuluar								
Gjendja më 31 Dhjetor 2012		268,532,623	19,908,211	81,325,181	100,112,429	69,745,549		539,623,993
sistemime		(268,532,623)	(19,908,211)	(81,325,181)	(100,112,429)	(69,745,549)		(539,623,993)
Amortizimi i vitit	-	94,773,674	14,406,992	10,708,700	27,907,818	29,000,002		176,797,186
Pakesime	-		(52,275)	(88,887)	(505,127)	(273,533)		(919,822)
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	**-**	**94,773,674**	**14,354,717**	**10,619,813**	**27,402,691**	**28,726,469**	**-**	**175,877,364**
Amortizimi i vitit		90,035,507	12,860,699	8,032,730	25,205,185	26,695,163		162,829,284
Pakesime				(108,340)				(108,340)
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	**-**	**184,809,181**	**27,215,416**	**18,544,203**	**52,607,876**	**55,421,632**	**-**	**338,598,308**
Vlera neto kontabël								
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	**304,303,068**	**1,000,872,529**	**81,799,514**	**57,301,324**	**143,112,430**	**121,550,987**	**1,614,000**	**1,710,553,852**
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	**379,999,919**	**1,800,699,780**	**79,487,746**	**42,945,451**	**127,793,443**	**113,315,228**	**2,690,000**	**2,546,931,567**
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	**379,999,919**	**1,710,664,273**	**68,207,368**	**41,796,879**	**121,617,550**	**91,740,875**	**2,690,000**	**2,416,716,864**

4. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE (VAZHDIM)

Shoqëria vlerëson aktivet e saj me vlerën e drejtë siç pershkruhet në shënimin 3.5 të këtyre pasqyrave financiare. Shoqëria ka kryer rivlerësimin e aktiveve afatgjata materiale më 31 Dhjetor 2012.

5. AKTIVET AFATGJATA JOMATERIALE

Lëvizjet e aktiveve afatgjata jomateriale për vitin 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

	AAJM	Total
Me kosto		
Gjendja më 1 Janar 2013	49,691,961	**49,691,961**
Shtesa	45,630	**45,630**
Pakesime		
Sistemime nga rivleresimi	(6,318,584)	**(6,318,584)**
Pakesime	-	
Gjendja me 31 Dhjetor 2013	43,419,007	**43,419,007**
Shtesa	10,870,200	**10,870,200**
Pakesime	-	-
Gjendja me 31 Dhjetor 2014	54,289,207	**54,289,207**
Amortizimi		-
Gjendja më 1 Janar 2013	6,318,526	**6,318,526**
Amortizimi i vitit	6,518,490	**6,518,490**
Kthim amortizimi		
Sistemime nga rivleresimi	(6,318,526)	**(6,318,526)**
Gjendja me 31 Dhjetor 2013	6,518,490	**6,518,490**
Amortizimi i vitit	7,040,089	**7,040,089**
Kthim amortizimi	-	-
Gjendja me 31 Dhjetor 2014	13,558,579	**13,558,579**
		-
Gjendja Neto me 31 Dhjetor 2013	**36,900,517**	**36,900,517**
Gjendja Neto me 31 Dhjetor 2014	**40,730,628**	**40,730,628**

6. AKTIVE AFATGJATA FINANCIARE

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Investime ne shoqerine Albtelecom	450,000,000	450,000,000
	450,000,000	**450,000,000**

7. PJESMARRJE NE NJESITE E KONTROLLUARA

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Investime ne shoqerin Interposta	1,000,000	1,000,000
	1,000,000	**1,000,000**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË POSTA SHQIPTARE SH.A TIRANË

8. INVENTARI

Gjëndjet e invetarit janë te analizuara si vijon:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Materiale te para	10,902,278	17,275,215
Materiale ndihmese	130,044,440	103,943,808
Lende djegese	8,865,720	6,659,035
Pjese kembimi	8,534,240	8,786,070
Inventar i Imet	45,348,769	40,344,935
Mallra per shitje	2,803,504	6,796,260
	206,498,951	**183,805,323**

9. LLOGARITË E ARKËTUESHME TREGTARE

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Kliente per shitje e sherbime	516,508,563	511,161,174
Kliente nderkombetar	51,303,452	32,119,194
Zhvleresimi i Kerkesave per arketim	-	-
	567,812,015	**543,280,368**

10. TE TJERA LLOGARITË E ARKËTUESHME AFATSHKURTRA

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Te Arketueshme nga Banka e Shqiperise per Bono Thesari	379,290,000	426,220,000
Tatim fitimi i parapaguar	5,821,531	65,210,915
Te drejta ndaj personelit	38,543,009	26,684,214
Debitore te tjere marredhenie me sportelin	39,664,125	50,888,481
Te tjera kerkesa	121,830,496	116,297,563
Llogari te arketueshme Interposta	615,316,963	496,357,590
	1,200,466,124	**1,181,658,763**

11. MJETET MONETARE

Mjetet monetare më 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 detajohen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Mjete monetare në banke		
Llogari rrjedhese	1,389,230,447	616,337,072
Depozita me Afat	237,711,634	261,393,000
Mjete monetare në arkë	601,788,828	370,103,571
Likuiditete te tjera	135,506,519	121,110,364
	2,364,237,428	**1,368,944,007**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - POSTA SHQIPTARE SH.A - TIRANE

(Të gjitha shumat janë paraqitur në Lek)

12. KAPITALI AKSIONAR

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Kapitali aksionar	1,642,447,000	1,642,447,000
Rezerva nga rivleresimi	1,380,951,364	1,448,592,294
Rezerva ligjore	103,250,221	103,250,221
Rezerva te tjera	1,044,369,902	1,044,369,902
Fitime te mbartura	12,068,326	61,249,922
Totali i te ardhurave gjitheperfshirese	229,699,353	(116,822,527)
	4,412,786,166	**4,183,086,812**

13. TATIM I SHTYRE MBI FITIMIN

Tatimi i shtyre mbi fitimin llogaritet per here te pare ne kete vit ushtrimor dhe per efekt krahasueshmerie eshte bere llogaritja e tij edhe per periudhen paraardhese, e cila paraqitet si me poshte:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Tatim i shtyre mbi fitimin	194,319,765	145,882,590
	194,319,765	**145,882,590**

14. DETYRIME TE TJERA AFTAGJATA

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Detyrime te tjera Afatgjata	450,000,000	450,000,000
	450,000,000	**450,000,000**

15. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE

Llogaritë e pagueshme tregtare paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Detyrime ndaj furnitoreve vendas	237,866,551	94,945,483
Detyrime ndaj furnitoreve te huaj	27,519,835	34,540,064
	265,386,386	**129,485,547**

16. DETYRIME TATIMORE

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Detyrime per Sigurime shoqerore	20,768,774	21,594,405
Tatim mbi te ardhurat Personale	1,354,050	3,221,603
TVSH per tu paguar	13,907,346	16,315,131
Tatim ne burim	793,510	716,929
	36,823,680	**41,848,068**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË POSTA SHQIPTARE SHA TIRANË

(Të gjitha shumat janë paraqitur në Lek)

17. DETYRIME NDAJ PERSONELIT

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Detyrime per paga	5,935,044	12,371,344
	5,935,044	**12,371,344**

18. GRANTE, TE ARDHURA TE SHTYRA E TE TJERA DETYRIME

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Te ardhura te shtyra	10,894,081	8,278,745
Total	**10,894,081**	**8,278,745**

19. TË TJERA LLOGARI TË PAGUESHME

Detyrimet të tjera afatshkurtra të shoqërisë janë të analizuara si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Detyrime per bono thesari	379,290,000	426,220,000
Detyrime me zyren e punes	-	321,302,267
Detyrime per pensione	541,467,808	382,474,222
Detyrime te tjera	950,559,080	211,570,950
	1,871,316,888	**1,341,567,439**

20. SHITJET NETO

	Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014	Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013
Te ardhura nga sherbime postare	853,077,785	736,933,512
Te ardhura nga sherbime financiare	959,528,908	876,395,130
Te ardhura nga sherbime telefonike	272,638	449,500
Te ardhura nga sherbime biznesi	33,588,274	33,524,864
Te ardhura nga sherbimi ekspres	74,016,845	51,185,675
Te ardhura nga sherbimi nderkombetar	93,833,054	82,193,692
Te ardhura nga eksporti	-	4,379,503
Te ardhura nga shtypi	11,193,124	
Total te ardhura nga veprimtaria kryesore	**2,025,510,628**	**1,785,061,876**
Te ardhura nga qeraja	151,620	
Te ardhura te tjera	5,679,359	294,864
Total te ardhura te tjera	**5,830,979**	**294,864**
Total shitje neto	**2,031,341,607**	**1,785,356,740**

REPUBLIKA E SHQIPERISE POSTA SHQIPTARE SH.A.E. TIRANE

(Të gjitha shumat janë paraqitur në Lek)

21. MATERIALE TE PARA DHE TE KONSUMUESHME

	Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014	Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013
Materiale te konsumuara	102,622,219	88,291,208
Kosto e Pulles	20,924,776	13,585,612
Konsumi i inventarit te imet	1,885,955	7,952,492
Shpenzime karburanti	47,863,939	52,448,187
Koeficenti i kreditimit	43,050,747	44,906,341
Total	**216,347,636**	**207,183,840**

22. SHPENZIME PERSONELI

	Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014	Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013
Shpenzime per paga	846,212,037	908,924,895
Shpenzime per sigurime shoqerore dhe shendetesore	122,174,208	154,073,433
Shperblime per punonjesit	30,512,623	2,277,706
Ndihma ekonomike	-	2,455,200
Total	**998,898,868**	**1,067,731,234**

23. SHPENZIME AMORTIZIMI DHE ZHVLERESIMI

	Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014	Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013
Shpenzime amortizimi	169,869,371	183,289,076
Total	**169,869,371**	**183,289,076**

REPUBLIKA E SHQIPERISE POSTA SHQIPTARE SH.A TIRANE

(Të gjitha shumat janë paraqitur në Lek)

24. SHPENZIME TE TJERA

	Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014	Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013
Shpenzime per energji elektrike	28,809,578	20,019,561
Shpenzime uji	2,916,259	3,208,180
Shpenzime qeraje	11,577,036	8,238,798
Shpenzime per mirembajte dhe riparime	45,600,011	44,942,687
Shpenzime siguracioni	1,290,211	1,377,193
Shpenzime per udhetim dhe dieta	20,049,476	23,544,126
Shpenzime telefonike	6,506,438	24,894,427
Shpenzime personel i jashtem	10,298,850	15,405,337
Shpenzime per reklama dhe publicitet	18,645,537	30,426,999
Shpenzime transport	5,813,104	6,833,579
Shpenzime per ruajte objektesh	34,354,978	32,678,438
Shpenzime per komisione bankare	34,637,409	29,907,948
shpenzime per sponsorizime	3,332,499	2,860,000
Shpenzime per agjent postar	24,428,046	
shpenzime postare nderkombetare	53,253,011	44,168,458
Shpenzime pritje , dhurata	8,196,848	6,513,774
Shpenzime gjoba dhe penalitete	24,551,714	3,946,725
Shpenzime per taksa	10,572,048	10,551,145
shpenzime me tjera	5,774,306	37,599,393
Vlera e mbetur e AAM-ve te dala	-	1,044,958
shpenzime per licenza/kuatizacioni	9,034,311	9,138,800
Total	**359,641,670**	**357,300,526**

25. TE ARDHURAT DHE SHPENZIMET FINANCIARE

	Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014	Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013
Te ardhura nga interesat	7,492,994	11,183,272
Te ardhura nga kembimet valutore	49,910,867	3,810,480
te ardhura te tjera financiare	6,270,515	353,663
Te Ardhurat Financiare	**63,674,376**	**15,347,415**
Shpenzime per interesa	-	-
Humbje nga kembimet valutote	(6,546,276)	(7,887,752)
Shpenzime te tjera financiare	(28,325)	(611,640)
Shpenzimet Financiare	**(6,574,601)**	**(8,499,392)**
Rezultati Financiar	**57,099,775**	**6,848,023**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË POSTA SHQIPTARE SH.A. TIRANË

(Të gjitha shumat janë paraqitur në Lek)

26. TATIMI MBI FITIMIN

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin eshte perllogaritur si me poshte:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Fitimi para tatimit	**343,683,837**	**(23,299,913)**
Shpenzime te panjohura (si me poshte)	**93,298,220**	**35,221,977**
Shpenzime amortizimi tej normave te lejuara	67,640,930	26,751,194
Shpenzime pritje & percjellje	990,788	1,118,917
Shpenzime sponsorizimi	-	2,860,000
Penalitet, gjoba e demshperblime	24,551,714	3,946,885
Shpenzime per dhurata	114,788	
Shpenzime pa dokumenta e te tjera		544,981
Fitimi para tatimit (perfshire shpenzimet e panjohura)	**436,982,057**	**11,922,064**
	-	
Tatim fitimi @15% (2013: 10%)	(65,547,309)	(1,192,206)
Fitimi /(Humbja) e vitit	**278,136,528**	**(24,492,119)**

27. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA

Shoqëria ka marrëdhënie me palë të lidhura me aksionerët e saj, me shoqeritë nën të njëjtin kontroll dhe me drejtimin dhe manaxhimin ekzekutiv të saj. Më poshtë janë detajuar palët e lidhura dhe marrëdhëniet respektive me to.

Vlerat e paraqitura ne seksionin a aktiveve me palët e lidhura me 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013.

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Llogari te arketueshme nga Interposta	615,316,963	496,357,590
Total llogari te arketueshme me palet e lidhura	**615,316,963**	**496,357,590**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË POSTA SHQIPTARE SH.A TIRANË

28. INSTRUMENTAT FINANCIARË MANAXHIMI I RISKUT FINANCIAR

Aktivitetet e shoqërise e ekspozojnë atë ndaj një sërë risqesh financiare si: risku i kreditit, risku i likuiditetit dhe risku nga monedhat e huaja. Shoqëria nuk perdor instrumenta financiarë derivativë ose ndonjë formë tjetër mbrojtje ndaj këtyre risqeve.

Nuk ekziston një kuadër i mirëfilltë formal i implementuar nga shoqëria për manaxhimin e riskut. Manaxhimi i shoqërise fokusohet më shumë në riskun e kreditit dhe riskun e likuiditetit dhe vepron rast pas rasti për të zbutur këto risqe dhe për të minimizuar humbjet.

Objektivat dhe politikat e manaxhimit të riskut financiar

Një instrument financiar është çdo kontratë që krijon të drejta për të marrë para ose asete të tjera financiare nga palët e tjera ose detyrimin për të dhënë asete të tjera financiare një palë tjetër. Instrumentat kryesore financiare të Shoqëriseë konsistojnë në para në dorë dhe në bankë, hua ndaj palëve të lidhura, llogari tregtare të arkëtueshme dhe të pagueshme dhe detyrime të tjera financiare. Instrumentat financiare krijojnë një risk për shoqërinë. Risqet më te rendesishme me të cilat përballet shoqëria janë si vijon:

28.1. Risku i Likuiditeteve

Shoqëria gjeneron flukse të mëdha të parasë nga aktivitetet operative (psh nga mbledhja e kërkesave të arkëtueshme) në atë masë sa që beson se rreziku i likuiditeteve nuk është domethënës.

28.2. Risku i normave të interesit

Risku i normes se interesit perbehet nga risku qe vlera e flukseve monetare te ardhshme te nje instrumenti financiar do te varioje per shkak te ndryshimeve ne normat e interesit ne treg dhe riskut qe maturitetet e aktiveve qe mbartin interes te ndryshojne nga maturitetet e detyrimeve qe mbartin interes te perdorura per te financuar ato aktive. Zgjatja kohore pergjate te ciles norma e interesit e nje instrumenti financiar eshte fikse, percakton se ne cfare mase eshte e ekspozuar ndaj riskut te normes se interesit.
Kompania nuk eshte e ekspozuar nga risku i normave te interesit.

28.3. Risku nga monedhat e huaja

Risku nga monedhat e huaja është risku që vlera e instrumentave financiare do të luhatet si pasojë e ndryshimeve në kurset e këmbimit të monedhave të huaja. Manaxhimi nuk është futur në ndonjë derivat për t'i vënë kufi ketij risku.

28.4. Risku i kreditit

Risku i kreditit eshte risku qe nje pale tjeter nuk do te jete ne gjendje te paguaje detyrimet e saj qe rrjedhin nga nje instrument financiar ose marreveshje klienti, duke cuar keshtu ne nje humbje financiare. Shoqeria eshte e ekspozuar ndaj riskut te kreditit per shkak te aktiviteteve operacionale te saj (pikesepari prej llogarive te arketueshme) dhe prej aktiviteteve te saj financuese, qe perfshijne depozitat me bankat dhe institucionet financiare, transaksionet ne monedha te huaja dhe instrumenta te tjere financiare.
Risku i kreditit eshte i kufizuar ne vleren kontabel te aktiveve financiare ne daten e raportimit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË POSTA SHQIPTARE SH.A. TIRANË

29. ANGAZHIME DHE PASIGURI

Çeshtje gjyqesore
Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2014 Shoqeria nuk ka asnje ceshtje gjyqesore te hapur kundrejt saj apo nga ajo, qe mund te kerkoje rregullime te ketyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore
Librat e Shoqerise nuk jane audituar nga organet tatimore per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014. Si rrjedhoje detyrimet tatimore nuk mund te konsiderohen perfundimtare. Detyrime te mundshme qe mund te rezultojne nga nje auditim i organeve tatimore nuk mund te maten ne menyre te besueshme.

30. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Më 31 Dhjetor 2014 në datën e pasqyrave financiare dhe deri në datën e aprovimit të tyre nuk ka ngjarje rregulluese të reflektuara në pasqyrat financiare ose ngjarje që janë materialisht të rëndësishme për të paraqitur në këto pasqyra.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË POSTA SHQIPTARE SH.A TIRANË